

JANAR 2026

EKONOMIA DHE BUXHETI

Raport Mujor

EKONOMIA DHE BUXHETI

Raport Mujor

Janar 2026

© Ministria e Financave, 2026

Drejtoria e Përgjithshme e Programimit Makroekonomik dhe Fiskal
Bulevardi "Dëshmorët e Kombit", Nr. 3, Tiranë

E-mail: Rei.Qerimi@financa.gov.al, Elkejdo.Pacani@financa.gov.al

Përmbajtja

VEÇORITË KRYESORE _____ **2**

ZHVILLIMET EKONOMIKE _____ **3**

1. Indeksi i Çmimeve të Konsumit _____ 3
2. Kursi Mesatar i Këmbimit _____ 4
3. Ecuria e Normave të Interesit të Depozitave dhe Huave _____ 5
4. Bilanci i Pagesave _____ 6
5. Mjetet Valutore Neto të Sistemit Bankar _____ 7
6. Kredia për Ekonominë _____ 8
7. Oferta e Parasë _____ 9
8. Depozitat sipas Burimeve _____ 10

SEKTORI FISKAL _____ **11**

1. Buxheti i Konsoliduar _____ 11
2. Të Ardhurat Sipas Burimeve _____ 12
3. Financimi i Bilancit Fiskal _____ 12

ANEKSI STATISTIKOR _____ **13**

Veçoritë Kryesore

- Indeksi i çmimeve të konsumit, në janar 2026, arriti në 101.46. Norma vjetore e inflacionit për muajin janar 2026 ishte 2.3 përqind;
- Kursi mesatar i këmbimit të monedhës vendase me dy monedhat kryesore të huaja për muajin janar 2026 ishte 82.27 lekë për dollarë dhe 96.56 lekë për euro;
- Normat mesatare të interesit të depozitave në lekë sipas individëve dhe korporatave jofinanciare gjatë muajit janar 2026 shënuan normën 1.59 dhe 2.23 përqind;
- Normat mesatare të interesit të huave në lekë sipas individëve dhe korporatave jofinanciare gjatë muajit janar 2026 shënuan normën 6.29 dhe 5.78 përqind;
- Oferta totale e parasë, e matur nga agregati M3, arriti në rreth 1,988,338 milionë lekë në muajin janar 2026, duke shënuar një rritje prej rreth 9.3 përqind krahasuar me një vit më parë;
- Bilanci i përgjithshëm i pagesave për tremujorin e tretë 2025 rezultoi pozitiv, në rritje të mjeteve të rezervës valutore, duke shënuar vlerën prej rreth 507.1 milionë euro;
- Situata buxhetore për muajin janar 2026 rezultoi me një suficit të përgjithshëm prej rreth 21.7 miliardë lekë, ndërkohë që ishte planifikuar një suficit prej 14.1 miliardë lekë;
- Të ardhurat gjithsej të realizuara për muajin janar 2026 arritën në rreth 70 miliardë lekë, ose afërsisht 8.3 përqind më shumë se muaji janar 2025 dhe 3.7 përqind më shumë krahasuar me planin e periudhës;
- Shpenzimet gjithsej gjatë së njëjtës periudhë arritën në rreth 48.3 miliardë lekë, ose rreth 3.9 përqind më shumë se muaji janar 2025 dhe 90.5 përqind realizim kundrejt planit të periudhës.

Zhvillimet Ekonomike

1. Indeksi i Çmimeve të Konsumit


Inflacioni vjetor për muajin janar 2026 shënoi normën 2.3%, duke reflektuar një rritje të lehtë në krahasim me një vit më parë kur ky ndryshim ishte 1.9%. Ndryshimi mujor i Indeksit të Çmimeve të Konsumit (IÇK) në muajin janar 2026, krahasuar me një muaj më parë, ka shënuar rritje me 0.4%.

Nga tërësia e mallrave dhe shërbimeve që përbëjnë shportën e konsumit, grupet të cilat patën kontributin më të lartë në inflacionin e përgjithshëm ishin:

“Ushqime dhe pije joalkoolike” me rritje vjetore të çmimit prej +1.8%, duke kontribuar me +0.61 pikë përqindje në inflacionin e përgjithshëm prej +2.3%.

“Qira, ujë, energji elektrike, gaz dhe karburante të tjera” me rritje vjetore të çmimit prej +4.4%, duke kontribuar me +0.87 pikë përqindje në inflacionin e përgjithshëm prej +2.3%.

“Mobilje, pajisje shtëpie dhe mirëmbajtje e shtëpisë”, me rritje vjetore +2.0%, duke kontribuar me +0.14 pikë përqindje në inflacionin e përgjithshëm prej +2.3%.



“Pije alkoolike dhe duhan” me rritje vjetore të çmimit prej +2.7%, duke kontribuar me +0.13 pikë përqindje në inflacionin e përgjithshëm prej +2.3%.

“Kujdes personal dhe mallra e shërbime të ndryshme” me rritje vjetore të çmimit prej +2.6%, duke kontribuar me +0.11 pikë përqindje në inflacionin e përgjithshëm prej +2.3%.

“Veshje dhe këpucë” me rritje vjetore të çmimit prej +0.3%, duke kontribuar me +0.01 pikë përqindje në inflacionin e përgjithshëm prej +2.3%.

“Restorante dhe shërbime akomodimi” me rritje vjetore të çmimit prej +2.4%, duke kontribuar me +0.14 pikë përqindje në inflacionin e përgjithshëm prej +2.3%.

VITI	Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor	Korrik	Gusht	Shtator	Tetor	Nëntor	Dhjetor
2025	2.0	1.9	2.1	2.3	2.2	2.4	2.5	2.3	2.4	2.3	2.1	2.3
2026	2.3											

Burimi: INSTAT

2. Kursi mesatar i këmbimit


Kursi mesatar i këmbimit të lekut kundrejt euros në muajin janar 2026 arriti në 96.56 lekë/euro, duke u rritur me 0.02 përqind krahasuar me një muaj më parë. Në fund të muajit janar, një euro u këmbye me 96.7 lekë. Gjatë muajit janar 2026 kundrejt dhjetor 2025, leku nuk ka patur ndryshim ndaj euros.

Kursi mesatar i këmbimit të lekut kundrejt dollarit amerikan në muajin janar 2026 arriti në 82.27 lekë/dollarë, duke shënuar rënie me 0.18 përqind kundrejt një muaji më parë. Në fund të muajit janar, kursi i këmbimit për dollarin amerikan arriti në nivelin 81.13 lekë/dollarë. Gjatë muajit janar 2026 kundrejt dhjetor 2025, vihet re një mbiçmim i lehtë i lekut ndaj dollarit në 0.2 përqind.

Kursi i këmbimit të euros me dollarin amerikan shënoi një nivel mesatar rreth 0.85 dollarë/euro për muajin janar 2026.


Në krahasim me muajin janar të vitit të kaluar, pas një periudhe të konsiderueshme forcimi, rezultojnë se monedha shqiptare ka pësuar një mbiçmim ndaj monedhës europiane në masën 1.98 përqind, ndërsa kundrejt dollarit amerikan rezultojnë se është mbiçmuar në masën 13.48 përqind.

Presionet mbiçmuese mbi kursin e këmbimit vijuan gjatë muajit janar 2026, por ato paraqiten më të moderuara krahasuar me dy vitet e mëparshme. Presionet e brendshme inflacioniste janë forcuar, në pasqyrim të zgjerimit të aktivitetit ekonomik, kushteve të shtrënguara në tregun e punës, si dhe rritjes së çmimit të qirave. Në të kundërt, presionet inflacioniste nga jashtë mbeten të dobëta, të kushtëzuara nga çmimet e ulëta të lëndëve bazë në tregjet ndërkombëtare dhe nga mbiçmimi i kursit të këmbimit të Lekut. Në përgjithësi, tregu valutash është karakterizuar nga një luhatshmëri e ulët.




3. Ecuria e Normave të Interesit të Depozitave dhe Huave

Gjatë muajit janar 2026, normat mesatare të interesit të depozitave me afat në lekë sipas Individëve dhe Korporatave jofinanciare shënuan përkatësisht normat prej 1.59 dhe 2.23 përqind. Krahasuar me një muaj më parë, normat e interesit të depozitave sipas Individëve janë rritur me 0.01 pikë përqindje, ndërsa për Korporatat jofinanciare janë rritur me 0.11 pikë përqindje. Ndërsa krahasuar me një vit më parë, normat e interesit të depozitave sipas Individëve kanë shënuar rënie me 0.10 pikë përqindje dhe janë ulur me 0.51 pikë përqindje për Korporatat jofinanciare.



Normat e interesit të bonove të thesarit 12-mujore, për muajin janar 2026, kanë shënuar normën 2.44 përqind, nga 2.78 përqind që shënonte të njëjtën periudhë një vit më parë. Norma e bonos 12-mujore nuk ka pasur ndryshim krahasuar me një muaj më parë ndërsa krahasuar me një vit më parë, ka shënuar rënie me 0.34 pikë përqindje.

Gjatë muajit janar 2026, normat mesatare të interesit të huave sipas Individëve dhe Korporatave jofinanciare shënuan normën 6.29 dhe 5.78 përqind. Krahasuar me një muaj më parë, normat e interesit të huave sipas Individëve u rritën me 0.31 pikë përqindje, ndërsa normat e interesit sipas Korporatave jofinanciare u ulën me 0.05 pikë përqindje. Ndërkohë, krahasuar me një vit më parë, normat e interesit të huave kanë shënuar rritje me 0.45 pikë përqindje për Individët dhe rënie me 0.67 pikë përqindje për Korporatat jofinanciare.





4. Bilanci i Pagesave T3-2025

Në tremujorin e tretë të vitit 2025, Bilanci i përgjithshëm i Pagesave rezultoi pozitiv, me rritje të mjeteve të rezervës valutore, duke shënuar vlerën prej rreth 507 milionë euro, nga -367 milionë euro që ishte në tremujorin e tretë 2024.

Llogaria korrente u mbyll me balancë pozitive prej rreth 658 milionë euro, zgjeruar në terma vjetorë me rreth 311 milionë euro. Zgjerimi i suficitit në shërbime mbetet faktori përcaktues i këtij rezultati. Llogaria financiare dhe kapitale rezultoi në fluks neto dalës prej rreth 226 milionë euro, krahasuar me -94 milionë euro në tremujorin e tretë 2024.


Investimet e huaja direkte u vlerësuan në 449 milionë euro ose +10.4 përqind më shumë, krahasuar me +406 milionë euro në tremujorin e tretë të vitit 2024. Të ardhurat në formën e prurjeve valutore nga emigrantët shënuan 285 milionë euro, ose +8.5 përqind, krahasuar me +262 milionë euro në tremujorin e tretë 2024.

Gjatë tremujorit të tretë 2025, mjetet e rezervës u zgjeruan me 507 milionë euro. Stoku i rezervës valutore, në fund të tremujorit të tretë 2025, shënon vlerën prej 7,269 milionë euro, mjaftueshëm për mbulimin e 11.7 muaj importe mesatare vjetore në mallra dhe shërbime.




5. Mjetet Valutore Neto të Sistemit Bankar

Gjatë muajit janar 2026, sistemi bankar ka shënuar vlerën prej rreth 1,128,698 milionë lekë të mjeteve valutore neto (M.V.N), duke u rritur me rreth 96,603 milionë lekë krahasuar me muajin janar 2025. Kjo rritje ka ardhur kryesisht si pasojë e rritjes së mjeteve valutore neto në Bankën Qendrore me 84,079 milionë lekë. Krahasuar me një muaj më parë, mjetet valutore neto kanë shënuar rritje me 3,688 milionë lekë, ku më së shumti ka kontribuar rritja mujore prej 2,448 milionë lekë në bankat e tjera depozituese.



Oferta totale e parasë, e matur nga agregati M3, arriti në rreth 1,988,338 milionë lekë në muajin janar 2026, duke shënuar një rritje prej 168,803 milionë lekë krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë, pra një rritje vjetore prej 9.3 përqind.





Në muajin janar, sistemi bankar rezultoi me rritje mujore prej 20,544 milionë lekë, ose 1.0 përqind më shumë krahasuar me muajin dhjetor 2025.

6. Kredia për Ekonominë

Totali i kredisë për ekonominë në muajin janar 2026 arriti në rreth 939,338 milionë lekë. Bilanci i kredisë, krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë, shënoi rritje në vlerë me 97,383 milionë lekë, ose rritje me rreth 11.6 përqind. Struktura e kredisë sipas monedhave është e balancuar mes monedhës kombëtare (59.1%) dhe monedhave të huaja (40.9%).

Gjatë muajit janar 2026, zëri “Korporata të tjera jofinanciare”, zuri peshën më të lartë të totalit të kredive, me rreth 54.5 përqind ose 511,579 milionë lekë, ndjekur nga kreditë për Individë, ku pesha e tyre specifike arriti në nivelin rreth 41.4 përqind ose rreth 388,659 milionë lekë. Zërat “Korporata jofinanciare publike” dhe “Korporata të tjera financiare” arritën respektivisht 1.9 dhe 2.2 përqind, ose 18,416 dhe 20,673 milionë lekë.

Për sa i përket shpërndarjes së kredisë sipas monedhës së huaj për muajin janar 2026, zëri “Korporata të tjera jofinanciare” zuri peshën më të lartë të kredive, me rreth 73.9 përqind, ndjekur nga “Sektorë të tjerë rezidentë” me rreth 22.3 përqind. “Korporata të tjera financiare” dhe “Korporata jofinanciare publike” kontribuojnë përkatësisht me 2.2 dhe 1.6 përqind secili.





7. Oferta e Parasë

Paraja jashtë Korporatave Depozituese arriti në rreth 481,172 milionë lekë në fund të muajit janar 2026. Raporti i Parasë jashtë Bankave me M3 në janar 2026 ka shënuar një rënie mujore prej 0.37 pikë përqindje dhe rritje vjetore prej 1.0 pikë përqindje, duke arritur nivelin 24.2 përqind. Raporti i Parasë jashtë Bankave me Depozitat ka shënuar rënie mujore prej 0.64 pikë përqindje dhe rritje vjetore prej 1.73 pikë përqindje, duke shënuar nivelin 31.9 përqind.

Depozitat në valutë, si përbërësi kryesor i ofertës monetare për muajin janar 2026, kanë shënuar rritje vjetore prej rreth 23,885 milionë lekë, e sjellë kryesisht nga depozitat për Individë, të cilat përbëjnë rreth 74.3 përqind të depozitave në valutë. Gjithashtu depozitat në Lekë, gjatë muajit janar 2026, shënuan rritje prej 85,787 milionë lekë në krahasim me muajin dhjetor 2025. Sektori i Individëve në Lekë ka zënë 73.5 përqind të depozitave në lekë.



Në muajin janar 2026, depozitat totale përbëjnë 75.8 përqind të agregatit M3, me një rënie rreth 1.0 pikë përqindje krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë.



8. Depozitat sipas Burimeve

Gjatë muajit janar 2026, zëri “Sektorë të tjerë rezidentë” zuri nivelin më të lartë të depozitave të transferueshme në lekë, me rreth 73.5 përqind, ndjekur nga “Korporata të tjera jofinanciare”, me rreth 18.7 përqind dhe nga “Korporata jofinanciare publike” me 5.5 përqind. “Sektorë të tjerë rezidentë” dhe “Korporata të tjera jofinanciare” ishin gjithashtu burimi më i rëndësishëm i depozitave në monedhë të huaj, përkatësisht me rreth 74.3 përqind dhe rreth 22.6 përqind. “Sektorë të tjerë rezidentë” ishin dukshëm burimi më i rëndësishëm i depozitave totale me rreth 73.9 përqind të totalit.

Në total, “Sektorë të tjerë rezidentë” përbëjnë pjesën më të madhe me rreth 1,114,324 milionë lekë të depozitave totale. Ato ndiqen nga “Korporata të tjera jofinanciare” (311,389 milionë lekë), “Korporata jofinanciare publike” (49,175 milionë lekë), “Korporata të tjera financiare” (25,377 milionë lekë) dhe “Qeveria lokale” me rreth 6,902 milionë lekë në totalin e depozitave. Gjatë muajit janar 2026, niveli i përgjithshëm i depozitave arriti vlerën rreth 1,507,167 milionë lekë. Krahasuar me një muaj më parë, niveli i depozitave shënoi rritje me rreth 22,818 milionë lekë. Ndërsa krahasuar me një vit më parë, totali i depozitave ka shënuar rritje me 109,672 milionë lekë.




Sektori Fiskal

1. Buxheti i Konsoliduar

Për muajin janar 2026 janë mbledhur rreth 70 miliardë lekë të ardhura, përkundrejt shpenzimeve të përgjithshme prej rreth 48.3 miliardë lekë, ku pjesa më e madhe përfshin 47.6 miliardë lekë shpenzimet korrente, nga të cilat rreth 20.1 miliardë lekë shpenzime për fonde speciale.

Nga të ardhurat gjithsej, pjesa e të ardhurave të mbledhura nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve (pa përfshirë kontributet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore) dhe Doganave është rreth 43.8 miliardë lekë (97.8% realizim kundrejt planit të periudhës). Të ardhurat e mbledhura nga pushteti vendor janë rreth 6.9 miliardë lekë (ose 243.6% më shumë se plani i periudhës). Të ardhurat nga fondet speciale janë rreth 17 miliardë lekë (ose 0.8% më shumë se plani i periudhës) dhe të ardhurat jotatimore në nivelin 2.2 miliardë lekë (ose 85.6% realizim kundrejt planit të periudhës).



Nga totali i shpenzimeve korrente prej 47.6 miliardë lekë, 10.3 miliardë lekë (21.6% e totalit të shpenzimeve korrente) është shpenzuar për personelin, rreth 9.3 miliardë lekë (19.5% e totalit të shpenzimeve korrente) për shpenzime interesi, 2.3 miliardë lekë (4.9% e totalit të shpenzimeve korrente) për shpenzime operative dhe mirëmbajtje, 0.1 miliardë lekë (0.2% e totalit të shpenzimeve korrente) për subvencione, 20.1 miliardë lekë (42.3%) për shpenzime për fonde speciale, 4.0 miliardë lekë (8.4% e totalit të shpenzimeve korrente) për shpenzimet e qeverisjes vendore, dhe 1.5 miliardë lekë (3.1% e totalit të shpenzimeve korrente) për shpenzime të tjera.

Shpenzimet kapitale për muajin janar 2026 janë realizuar në masën 728 milionë lekë.

2. Të ardhurat sipas burimeve

Të ardhurat gjithsej të realizuara për muajin janar 2026 ishin rreth 70 miliardë lekë, nga të cilat të ardhurat tatimore rreth 67.7 miliardë lekë, të ardhurat jotatimore në rreth 2.2 miliardë lekë.

Tab - 2

Të ardhurat tatimore gjatë muajit Janar 2026 (mln Lekë)

Emërtimi	Janar'26	Janar'25	Janar'26/ Janar'25 Rritja në (%)
Tatimi mbi Vlerën e Shtuar	22,475	22,020	2.1
Tatimi mbi Fitimin	3,442	2,964	16.1
Akcizat	5,208	4,867	7.0
Tatimi mbi të Ardhurat Personale	7,606	7,277	4.5
Taksa Nacionale dhe të tjera	4,414	4,923	-10.3
Taksa Doganore	614	586	4.8

Burimi: Ministria e Financave, Statistikat Fiskale: Mars 2026

3. Financimi i Bilancit Fiskal

Balanca buxhetore për muajin janar 2026 shënoi një suficit prej rreth 21.7 miliardë lekë, ndërkohë që ishte planifikuar një suficit prej 14.1 miliardë lekë. Suficiti prej 21.7 miliardë lekë u përdor për financimin e deficitit të brendshëm prej 20.5 miliardë lekë si dhe deficitit të huaj prej 1.2 miliardë lekë .

Për muajin janar 2026, disa nga treguesit kryesorë fiskalë ishin:

- Realizimi i të ardhurave në masën 70 miliardë lekë;

- Realizimi i shpenzimeve në masën 48.3 miliardë lekë.

Në realizimin e të ardhurave për muajin janar 2026, kontributin kryesor e kanë dhënë të ardhurat tatimore, të cilat arrijnë shifrën e 67.7 miliardë lekë. Në realizimin e shpenzimeve për këtë periudhë, peshën më të lartë e zënë shpenzimet korrente me 47.6 miliardë lekë dhe shpenzimet për fonde speciale me rreth 20.1 miliardë lekë.

Aneksi Statistikor

Tab - 1

Muaji	Mujor (Monthly)					Mesatar Mujor (Monthly Average)					Vjetor (Annual)					Month
	2022	2023	2024	2025	2026	2022	2023	2024	2025	2026	2022	2023	2024	2025	2026	
Janar	1.3	1.1	0.5	0.4	0.4	1.3	1.1	0.5	0.4	0.4	3.7	7.2	3.4	2.0	2.3	January
Shkurt	1.3	1.1	0.3	0.3		1.3	1.1	0.4	0.4		3.9	7.1	2.6	1.9		February
Mars	2.4	0.7	0.4	0.6		1.7	1.0	0.4	0.4		5.7	5.3	2.3	2.1		March
Prill	0.7	0.0	-0.2	0.1		1.4	0.9	0.3	0.4		6.2	4.6	2.1	2.3		April
Maj	-0.5	-0.3	-0.2	-0.3		1.0	0.7	0.2	0.2		6.7	4.7	2.2	2.2		May
Qershor	-0.1	-0.3	-0.4	-0.2		0.9	0.6	0.3	0.2		7.4	4.5	2.1	2.4		June
Korrik	0.2	-0.1	-0.2	-0.1		0.8	0.5	0.2	0.1		7.5	4.2	2.1	2.5		July
Gusht	0.8	0.6	0.5	0.3		0.8	0.5	0.2	0.1		8.0	4.0	2.0	2.3		August
Shtator	0.6	0.7	0.6	0.7		0.7	0.4	0.1	0.2		8.1	4.1	1.9	2.4		September
Tetor	0.4	0.1	0.1	0.1		0.7	0.4	0.1	0.2		8.3	3.8	1.9	2.3		October
Nëntor	-0.3	-0.2	0.0	-0.2		0.6	0.3	0.1	0.2		7.9	3.9	2.0	2.1		November
Dhjetor	0.4	0.5	0.6	0.7		0.6	0.3	0.2	0.2		7.4	4.0	2.1	2.3		December

Burimi : INSTAT

Source : INSTAT

Tab - 2

Kursi i këmbimit

Exchange rate

Monedha	2022	2023	2024	2025	2026 Janar January	Currency
Mesatarja e periudhës						Average of period
USD	113.04	100.65	93.09	86.80	82.27	USD
EURO	118.98	108.80	100.71	97.85	96.56	EURO
Fundi i periudhës						In the end of period
USD	107.05	93.94	94.26	82.46	81.13	USD
EURO	114.23	103.88	98.15	96.77	96.70	EURO

Burimi : Banka e Shqipërisë**Source** : Bank of Albania

Tab - 3

Normat e interesit me bazë vjetore (në Lek)*Annual Interest Rates (in ALL)*

Në përqindje	2026 Janar January	In percent
<i>Norma e interesit të depozitave për individët</i> <i>Interest rates on households deposits</i>		
Deri në 1 vit	1.29	Up to 1 year
Nga 1-2 vite	1.59	From 1 to 2 years
Mbi 2 vjet	2.44	Over 2 years
<i>Norma e interesit të depozitave për korporatat jofinanciare</i> <i>Interest rates on nonfinancial corporations deposits</i>		
Deri në 1 vit	2.11	Up to 1 year
Nga 1-2 vite	2.70	From 1 to 2 years
Mbi 2 vjet	2.75	Over 2 years
<i>Normat e interesit të kredive për individët</i> <i>Interest rates on household loans</i>		
Kredi për banesa	3.91	Lending for house purchase
Kredi konsumatore	8.63	Consumer credit
Kredi për qëllime të tjera	13.10	Credit for other purposes
<i>Normat e interesit të kredive për korporatat jofinanciare</i> <i>Interest rates on nonfinancial corporations loans</i>		
Kredi deri në 140 milionë lekë	6.79	Loans up to to an amount of 140 millions of lek
Kredi mbi 140 milionë lekë	5.10	Loans over an amount of 140 millions of lek
<i>Norma e letrave me vlerë</i> <i>Securities rates</i>		
Bono thesari 1/		Treasury bills 1/
3-M	2.46	3-M
6-M	-	6-M
12-M	2.44	12-M

Burimi: Banka e Shqipërisë**Source:** Bank of Albania

TREGUESIT FISKAL SIPAS BUXHETIT TË KONSOLIDUAR 2026

Fiscal indicators regarding consolidated budget of 2026

Të dhëna progresive (Progressive Data)

në milionë Lek (in million ALL)

Nr.	E M Ë R T I M I	January Janar	ITEMS
	TOTALI TË ARDHURAVE	69,988	TOTAL REVENUE
I.	Të ardhura nga ndihmat	158	Grands
II.	Të ardhura tatimore	67,671	Tax Revenue
II.1	Nga Tatimet dhe Doganat	43,760	From tax offices and customs
1	Tatimi mbi Vlerën e Shtuar	22,475	V.A. T
2	Tatimi mbi Fitimin	3,442	Profit Tax
3	Akcizat	5,208	Excise Tax
4	Tatimi mbi të Ardhurat Personale	7,606	Personal Income Tax
5	Taksa Nacionale dhe të tjera	4,414	National Taxes and others
6	Taksa Doganore	614	Customs Duties
II.2	Të ardhura nga Pushteti Vendor	6,875	Revenues from Local Gov.
1	Taksë mbi Pasurinë (ndërtesat)	539	Property Tax
2	Taksë mbi Biznesin e vogël	15	Small Business Tax
3	Taksa Lokale	6,321	Local Taxes
II.3	Të ardhura nga fondet speciale	17,035	Social ins. contributions
1	Sigurimi Shoqëror	14,653	Social Insurance
2	Sigurimi Shëndetësor	2,316	Health insurance
3	Të ardhura për kompensim në vlerë të pronarëve	66	Compensation income in the value of owners
III.	Të ardhura Jotatimore	2,159	Nontax Revenue
1	Tran.Fitimi nga Banka e Shqipërisë	0	Profit transfer from BOA
2	Të ardhura nga Inst.Buxhetore	1,071	Income of budgetary institutions
3	Tarifat shërbimeve	364	Utility fees
4	Të tjera	724	Others
	TOTALI I SHPENZIMEVE	48,286	TOTAL EXPENDITURE
I.	Shpenzime Korrente	47,558	Current Expenditures
I.1	Personeli	10,288	Personnel expenditures
1	Paga	8,826	Wages
2	Kontributi për Sigurime Shoqërore	1,451	Social insurance contributions
3	Arsimi i lartë nga të ardhurat e veta	12	Higher education from its own income
I.2	Interesat	9,274	Interest
1	Të Brendshme	8,365	Domestic
2	Të Huaja	909	Foreign
I.3	Shpenzime Operative Mirëmbajtje	2,305	Operational & Maintenance
I.4	Subveconet	109	Subsidies
I.5	Shpenzime për fonde speciale	20,093	Social insurance outlays
1	Sigurime Shoqërore	16,066	Social insurance
2	Sigurime Shëndetësore	4,043	Health insurance
3	Fondi i kompensimit të pronarëve	-17	Owners' Compensation Fund
I.6	Shpenzime për Buxhetin Vendor	3,997	Local budget expenditure
I.7	Shpenzime të tjera	1,492	Other expenditures
1	Pagesa e Papunesisë	59	Unemployment insurance benefits
2	Ndihma Ekonomike	1,433	Economic Aid
3	Kompensim për ish të përndjekurit politike	0	Compensation for the political persecuted
II	Fondi Rezerve, Kontigjenca	0	Reserve fund/contingency
III	Shpenzime Kapitale	728	Capital expenditures
1	Financimi i Brendshëm	0	Domestically financing
2	Investime nga të ardhurat e Arsimit të Lartë	0	From higher education system's own revenues
3	Financimi i Huaj	728	Foreign financed
IV	Fondi i rindërtimit	0	Reconstruction fund
V.	DEFICITI	21,703	CASH BALANCE
V.1	FINANCIMI DEFICITIT	-21,703	CASH BALANCE FINANCING
V.2	Brendshëm	-20,513	Domestic
1	Të ardhura nga privatizimi	3	Privatization receipts
2	Hua-marrje e brendshme	-13,428	Domestic new borrowing (net)
3	Të tjera	-7,088	Others
V.3	I huaj	-1,190	Foreign
1	Hua afatgjatë(e marrë)	517	Long-term foreign borrowing (gross)
2	Ndryshimi i gjendjes së arkës*	106	Chang. of stat. Account
3	Ripagesat	-1,813	Repayments
4	Mbështetje Buxhetore	0	Budgetary Support

Burlmi : Ministria e Financave

Source : Ministry of Finance

* "Ndryshimi i gjendjes së arkës" përfaqëson ndryshimin e Depozitës së Financimeve të Huaja.

Tab - 5

Tabela e investimeve 2026

Table of investments 2026

Të dhëna progresive (Progressive Data)

në milionë Lek (in million ALL)

	Janar January	
Financim i brendshëm	-20,513	Domestic financing
<i>Në %</i>	94.5	<i>In %</i>
Financim i huaj	-1,190	Foreign financing
<i>Në %</i>	5.5	<i>In %</i>
Totali	-21,703	Total
<i>Në %</i>	100	<i>In %</i>

Burimi: Ministria e Financave

Source: Ministry of Finance

**Tab - 6 TË ARDHURAT DOGANORE DHE TATIMORE 2026
CUSTOMS AND TAX REVENUES 2026**

Të dhëna progresive (Progresive Data)

në milionë Lek (in million ALL)

	Janar January	
TË ARDHURAT DOGANORE 2026 (CUSTOMS REVENUE)		
Taksë doganore	614	Customs Duties
TVSH	10,123	V.A.T
Akcizë	5,208	Excises
Të tjera (Renta Minerare)	63	Others (Mineral Rent)
TOTALI	16,008	Total
TË ARDHURAT TATIMORE 2026 (TAX REVENUE)		
TVSH	12,352	V.A.T
Tatim mbi fitimin	3,442	Profit Tax
Tatimi mbi të ardhurat personale	7,606	Personal income tax
Taksa nacionale dhe të tjera	4,351	National taxes
TOTALI	27,752	Total
TOTALI I PËRGJITHSHËM	43,760	OVERALL TOTAL

Burimi: Ministria e Financave

Source: Ministry of Finance

Tab - 7

DEFICITI DHE FINANCIMI PËR 2026

*The Deficit and Its Financing for 2026**Të dhëna progresive (Progressive Data)**në milionë Lek (in million ALL)*

	Janar January	
TË ARDHURAT	69,988	REVENUE
SHPENZIMET	48,286	EXPENDITURES
BILANCI FISKAL	21,703	FISCAL BALANCE
FINANCIMI I BILANCIT FISKAL	-21,703	FINANCING
Financimi i brendshëm	-20,513	Domestic
Të ardhura nga privatizimi	3	Privatization receipts
Hua-marrje e brendshme	-13,428	Domestic borrowing
Të tjera	-7,088	Others
Financimi i jashtëm	-1,190	Foreign
a. Hua afatgjatë (e marrë)	517	Long-term foreign borrowing (gross)
b. Ndryshimi i gjendjes së arkës*	106	Chang. of stat. Account
c. Ripagesat	-1,813	Repayments
d. Mbështetje Buxhetore	0	Budgetary Support

Burimi: Ministria e Financave**Source:** Ministry of Finance

BILANCI I PAGESAVE

Balance of payments

Në milionë Euro

In millions Euro

	2021	2022	2023	2024	T1-2024	T2-2024	T3-2024	T4-2024	T1-2025	T2-2025	T3-2025	
Llogaria korrente	-1,180.96	-1,118.48	-364.08	-608.68	-357.50	-220.74	346.22	-376.67	-316.76	-290.06	657.70	Current Account.
Bilanci tregtar	-3,843.07	-4,320.97	-4,633.52	-5,592.91	-1,236.16	-1,354.94	-1,455.36	-1,546.45	-1,271.75	-1,482.48	-1,612.81	Trade Balance.
Eksporti I mallrave fob	1,251.06	1,880.46	1,742.43	1,678.80	389.57	488.26	407.71	393.26	399.61	425.73	333.51	Merchandise Exports. Fob
Importi I mallrave fob	5,094.13	6,201.43	6,375.96	7,271.71	1,625.73	1,843.21	1,863.07	1,939.70	1,671.36	1,908.21	1,946.32	Merchandise Imports. Fob
Bilanci i shërbimeve	1,795.05	2,398.20	3,351.11	3,875.55	629.06	864.17	1,496.00	886.32	693.45	891.96	1,895.47	Services Balance.
Shërbimet Kredi	3,484.98	4,798.25	6,564.98	7,409.82	1,365.22	1,738.69	2,587.54	1,718.38	1,491.75	1,859.86	3,137.17	Services Credit
Shërbimet Debi	1,689.93	2,400.05	3,213.87	3,534.27	736.15	874.52	1,091.54	832.06	798.30	967.90	1,241.70	Services Debt
Bilanci i të ardhurave	-210.93	-314.76	-278.45	-192.76	-47.05	-68.38	-24.16	-53.18	-40.56	-41.86	21.61	Balance of Incomes
Të ardhurat Kredi	397.62	596.79	771.30	958.77	217.87	240.89	264.20	235.82	228.88	259.13	285.18	Income Credit
Të ardhurat Debi	608.55	911.55	1,049.75	1,151.54	264.91	309.27	288.36	288.99	269.45	300.99	263.57	Income Debt
Bilanci i transfertave	1,077.98	1,119.06	1,196.78	1,301.44	296.64	338.42	329.74	336.64	302.10	342.32	353.43	Balance of Transfers
Transferta private	1,244.02	1,280.21	1,367.95	1,507.51	344.39	386.93	382.07	394.11	357.46	396.31	410.29	Private Unrequired Transfers
Transferta shtetërore	166.04	161.16	171.18	206.07	47.75	48.51	52.33	57.47	55.36	53.99	56.85	Official Unrequired Transfers
Llogaria kapitale	359.25	20.14	45.81	-156.44	-74.74	-65.25	-60.13	43.68	-35.04	-8.10	-17.78	Capital Account
Llogaria financiare	-1,565.98	-820.99	-1,002.05	-892.46	-137.67	-220.53	33.53	-567.79	-928.13	-268.67	208.17	Financial Account
Investime direkte	-989.93	-1,189.95	-1,255.64	-1,340.04	-282.61	-326.82	-348.64	-381.98	-293.19	-305.60	-377.14	Direct Investment
Investime portofoli	-96.45	573.11	326.51	404.94	157.76	-52.81	118.18	181.82	-560.99	-95.95	234.65	Portfolio Investment
Investime të tjera	-533.13	-266.63	-176.45	-98.97	-54.64	123.59	222.89	-394.93	-115.78	106.23	336.60	Other Capital
Gabime dhe harresa neto	191.90	207.55	253.03	136.37	14.47	-51.34	114.61	58.63	0.06	82.37	75.30	Net errors and omissions
Bilanci i përgjithshëm	936.17	-69.80	936.81	263.71	-280.10	-116.80	367.17	293.43	576.39	52.88	507.05	Overall Balance
Rezervat	936.17	-69.80	936.81	263.71	-280.09	-116.79	367.17	293.43	576.39	52.89	507.05	Reserve Assets
Përdor kred & huash nga FMN	-53.54	-62.48	-103.53	-141.59	-41.03	-32.50	-40.77	-27.29	-41.84	-26.65	-14.06	Use of Fund Credit and Loans

Burimi: Banka e Shqipërisë

Source: Bank of Albania

MJETET VALUTORE NETO

Net Foreign Assets

Në milionë Lekë Fundi i periudhës	2022	2023	2024	2025	2026 Janar January	Millions of Lek End of Period
	Mjete valutore neto	892,687	974,610	1,016,861	1,125,009	
Pretendime ndaj jorezidentëve	981,133	1,054,373	1,101,478	1,265,904	1,244,463	Claims on nonresidents
Minus Detyrime të jorezidentëve	88,446	79,763	84,617	140,894	115,765	Minus: Liabilities to nonresidents
Mjetet e brendshme	1,211,348	1,218,505	1,326,853	1,455,250	1,485,238	Domestic assets
Pretendimet neto ndaj qeverisë qendrore	491,750	467,994	483,962	504,720	538,739	Net claims on central government
Pretendime ndaj sektorëve të tjerë	719,598	750,511	842,892	950,530	946,499	Claims on other sectors
Detyrimet e parasë së gjerë	1,659,293	1,698,232	1,785,240	1,967,624	1,988,338	Broad Money liabilities
Paraja jashtë Korporatave Depozituese	387,652	393,555	423,539	483,447	481,172	Money outside depository corporations
Depozita të transferueshme	645,637	689,496	727,641	806,699	826,185	Transferable deposits
Depozita të tjera	626,005	615,181	634,059	677,477	680,981	Other deposits
Depozita të papërfshira në paranë e gjerë	248,219	297,573	330,099	355,060	355,835	Deposits excluded from Broad Money
Qeveria lokale dhe administrata publike						Local government and public administration
Korporata të tjera financiare	7,250	8,018	11,289	9,442	9,585	Other financial corporations
Korporata jofinanciare publike	382	338	464	687	687	Public nonfinancial corporations
Korporata të tjera jofinanciare	10,186	14,936	19,479	22,495	22,634	Other nonfinancial corporations
Sektorë të tjerë rezidentë	230,401	274,281	298,867	322,436	322,928	Other resident sectors
Letrat me vlerë të ndryshme nga aksionet	7,925	13,331	20,320	28,668	28,616	Securities other than shares
Korporata të tjera jofinanciare	291	614	1,167	1,415	1,405	Korporata të tjera jofinanciare
Sektorë të tjerë rezidentë	7,634	12,717	19,153	27,253	27,211	Other resident sectors
Huatë	4,636	5,880	4,609	8,693	14,889	Loans
Qeveria lokale dhe administrata publike						Local government and public administration
Korporata të tjera financiare	4,636	5,880	4,609	8,693	14,889	Other financial corporations
Korporata jofinanciare publike						Public nonfinancial corporations
Korporata të tjera jofinanciare						Other nonfinancial corporations
Sektorë të tjerë rezidentë						other resident sectors
Llogari të pagueshme	86	110	42	58	116	Accounts payable
Korporata të tjera financiare						Other financial corporations
Korporata jofinanciare publike						Public nonfinancial corporations
Korporata të tjera jofinanciare	69	0	0	1	1	Other nonfinancial corporations
Sektorë të tjerë rezidentë	17	110	42	57	115	other resident sectors
Aksione dhe instrumenta të tjerë të kapitalit	185,627	191,673	215,674	244,388	247,018	Shares and other equity
Nga të cilat rezerva rivlerësimi	-46,110	-73,603	-76,032	-75,466	-71,105	Of which: Valuation adjustment
Të tjera neto	-12,607	-15,143	-15,799	-25,792	-22,683	Other items net
Detyrime të tjera	63,859	63,848	68,017	68,995	71,761	Other liabilities
Minus: Mjete të tjera	76,467	78,990	83,816	94,787	94,444	Minus: Other assets
Axhustimi i konsolidimit	4,826	1,459	3,529	1,560	1,806	Consolidation adjustment

Burimi : Banka e Shqipërisë

Source : Bank of Albania

Tab - KREDIA PËR EKONOMINË
10 Credit to Economy

Në milionë Lekë Fundi i periudhës	2022	2023	2024	2025	2026 Janar January	Millions of Lek End of Period
Totali i kredisë	713,552	744,162.7	835,816.7	943,744.9	939,337.7	Total Credit
Kredia për qeverinë lokale dhe administratën publike	205	103.0	23.9	11.4	10.8	Credits to local Government
Në lekë	204.79	103.0	23.9	11.4	10.8	in Lek
Në valutë	-	-	-	-	-	in Foreign Currency
Kredia për korporatat jofinanciare publike	23,714	16,754.0	18,958.8	18,999.2	18,416.2	Credits to Public Non-financial Corporations
Në lekë	10,509	9,247.1	7,354.1	12,345.3	12,164.4	in Lek
Në valutë	13,205	7,506.9	11,604.7	6,654.0	6,251.7	in Foreign Currency
Kredia për korporatat e tjera jofinanciare	411,853	421,985.1	469,926.0	516,591.2	511,578.6	Credits to other Non-financial Corporations
Në lekë	173,607	196,936.3	216,945.6	230,171.7	227,553.5	in Lek
Në valutë	238,246	225,048.8	252,980.4	286,419.5	284,025.1	in Foreign Currency
Kredia për korporatat e tjera financiare	15,557	19,468.4	22,212.3	20,820.0	20,673.2	Credits to Other Financial Corporations
Në lekë	8,669	12,411.3	14,719.3	12,293.1	12,098.7	in Lek
Në valutë	6,888	7,057.0	7,493.0	8,526.8	8,574.5	in Foreign Currency
Kredia për sektorë të tjerë rezidentë	262,223	285,852.2	324,695.7	387,323.2	388,659.0	Credits to other resident sectors
Në lekë	175,901	204,247.5	245,076.4	300,731.8	303,253.1	in Lek
Në valutë	86,322	81,604.7	79,619.3	86,591.4	85,405.9	in Foreign Currency

Burimi : Banka e Shqipërisë

Source : Bank of Albania

Tab - 11 **OFERTA E PARASË**
Money Supply

Mujor-Monthly

Në milionë Lekë	2022	2023	2024	2025	2026	
Fundi i periudhës					Janar	Millions of Lek
					January	End of Period
Baza monetare	619,187	632,446	613,646	676,586	682,616	Monetary base
Paraja jashtë korporatave depozituese	387,652	393,796	423,539	483,447	481,172	Currency outside depository corporations
Agregati M1	735,839	772,430	845,660	967,788	988,414	M1 Aggregate
Agregati M2	939,309	976,037	1,052,791	1,194,059	1,218,503	M2 Aggregate

Burimi : Banka e Shqipërisë

Source : Bank of Albania

DEPOZITAT

Deposits

Mujor-Monthly

Në milionë Lekë Fundi i periudhës	2022	2023	2024	2025	2026 Janar January	Millions of Lek End of Period
Totali i depozitave	1,271,642	1,304,677	1,361,701	1,484,177	1,507,167	Total deposits
Në lekë	551,657	579,058	629,252	710,613	737,331	In local currency
Depozitat e transferueshme	291,263	323,847	362,855	417,954	440,256	Transferable deposits
Qeveria lokale dhe administrata publike	1,694	2,000	3,536	2,702	3,118	Local governments and public administration
Korporata jofinanciare publike	16,031	21,228	22,175	24,937	33,902	Public nonfinancial corporations
Korporata të tjera financiare	7,045	5,133	5,818	5,974	5,996	Other financial corporations
Korporata të tjera jofinanciare	77,667	91,605	96,156	108,851	119,711	Other nonfinancial corporations
Sektorë të tjerë rezidentë	188,826	203,881	235,169	275,490	277,528	Other resident sectors
Depozita me likuiditet të lartë (Depozita pa afat)	56,924	55,111	59,266	66,387	66,987	Liquid deposits (Sight deposits)
Qeveria lokale dhe administrata publike						Local governments and public administration
Korporata jofinanciare publike	2,636	1,669	3,535	1,050	1,036	Public nonfinancial corporations
Korporata të tjera financiare	37	46	1	25	0	Other financial corporations
Korporata të tjera jofinanciare	2,493	3,745	3,821	6,640	6,418	Other nonfinancial corporations
Sektorë të tjerë rezidentë	51,758	49,651	51,909	58,672	59,533	Other resident sectors
Depozita të tjera	203,470	200,101	207,131	226,271	230,089	Other deposits
Qeveria lokale dhe administrata publike			1,003	1,007	1,010	Local governments and public administration
Korporata jofinanciare publike	598	2,656	3,901	5,235	5,575	Public nonfinancial corporations
Korporata të tjera financiare	5,114	5,386	5,659	6,837	6,924	Other financial corporations
Korporata të tjera jofinanciare	6,379	9,553	9,789	10,298	11,452	Other nonfinancial corporations
Sektorë të tjerë rezidentë	191,379	182,506	186,778	202,892	205,128	Other resident sectors
Në valutë	719,985	725,619	732,449	773,564	769,836	In foreign currency
Depozitat e transferueshme	354,374	365,649	364,787	388,745	385,930	Transferable deposits
Qeveria lokale dhe administrata publike	76	154	106	121	136	Local governments and public administration
Korporata jofinanciare publike	3,901	4,128	3,967	6,076	6,604	Public nonfinancial corporations
Korporata të tjera financiare	6,598	5,425	5,416	5,049	4,864	Other financial corporations
Korporata të tjera jofinanciare	136,911	148,159	144,201	153,523	149,853	Other nonfinancial corporations
Sektorë të tjerë rezidentë	206,889	207,783	211,098	223,975	224,473	Other resident sectors
Depozita me likuiditet të lartë (Depozita pa afat)	139,409	129,272	126,200	129,044	128,999	Liquid deposits (Sight deposits)
Qeveria lokale dhe administrata publike			1.48	1	1	Local governments and public administration
Korporata jofinanciare publike	101	6	6	6	6	Public nonfinancial corporations
Korporata të tjera financiare	1	0	0	5	5	Other financial corporations
Korporata të tjera jofinanciare	4,702	6,408	5,970	6,840	6,448	Other nonfinancial corporations
Sektorë të tjerë rezidentë	134,605	122,856	120,222	122,192	122,540	Other resident sectors
Depozita të tjera	226,202	230,698	241,462	255,775	254,907	Other deposits
Qeveria lokale dhe administrata publike	984	219	2,571.8	2,635	2,637	Local governments and public administration
Korporata jofinanciare publike	2,607	2,923	2,374	2,045	2,052	Public nonfinancial corporations
Korporata të tjera financiare	7,561	8,174	10,107	8,113	7,588	Other financial corporations
Korporata të tjera jofinanciare	23,903	22,444	19,467	18,062	17,507	Other nonfinancial corporations
Sektorë të tjerë rezidentë	191,147	196,937	206,942	224,920	225,122	Other resident sectors

Burimi : Banka e Shqipërisë

Source : Bank of Albania

Tregues të shëndetit financiar (FSI)

(në përqindje)

Financial Soundness Indicators (FSI)

(in percentage)

Përshkrimi i treguesit	Janar'26	Indicator's description
Tregues me bazë kapitalin		Capital-based
Kapitali rregullator ndaj aktiveve të ponderuara me rrezik (në %)	-	Regulatory capital as a percent of risk-weighted assets (in %)
Kapitali rregullator (mln lekë)	-	Regulatory capital (million lek)
Aktive të ponderuara me rrezik (mln lekë)	-	Risk-weighted assets
Kapitali rregullator i nivelit I ndaj aktiveve të ponderuara me rrezik (në %)	-	Regulatory Tier 1 capital as a percent of risk-weighted assets (in %)
Kapitali ndaj totalit të aktiveve		Capital as a percent of total assets
Kapitali rregullator i nivelit I ndaj totalit të aktiveve	8.91	Regulatory Tier 1 capital as a percent of total assets
Kapitali rregullator ndaj totalit të aktiveve (në %)	9.85	Regulatory capital as a percent of total assets (in %)
Kapitali aksioner ndaj totalit të aktiveve (në %)	10.13	Shareholders' equity as a percent of total assets (in %)
Huatë me probleme neto nga provigjonet ndaj kapitalit (në %)		Nonperforming loans net of provisions as a percent of capital (in %)
Huatë me probleme neto nga provigjonet ndaj kapitalit rregullator të nivelit I (në %)	6.25	Nonperforming loans net of provisions as a percent of regulatory Tier1 capital (in %)
Huatë me probleme neto nga provigjonet ndaj kapitalit rregullator (në %)	5.65	Nonperforming loans net of provisions as a percent of regulatory capital (in %)
Huatë me probleme neto nga provigjonet ndaj kapitalit aksioner (në %)	5.50	Nonperforming loans net of provisions as a percent of shareholders' equity (in %)
Kthimi nga kapitali (ROE) (bazë vjetore) (në %)	13.90	Return on equity (ROE) (annual basis) (in %)
Pozicioni i hapur neto në valutë ndaj kapitalit (në %)		Net open position in foreign exchange as a percent of capital (in %)
Pozicioni i hapur neto në valutë ndaj kapitalit rregullator të nivelit I (në %)	5.74	Net open position in foreign exchange as a percent of regulatory Tier 1 capital (in %)
Pozicioni i hapur neto në valutë ndaj kapitalit rregullator (në %)	5.19	Net open position in foreign exchange as a percent of regulatory capital (in %)
Pozicioni i hapur neto në valutë ndaj kapitalit aksioner (në %)	5.05	Net open position in foreign exchange as a percent of shareholders' capital (in %)
Tregues me bazë aktivet		Asset-based indicators
Aktive likuide ndaj totalit të aktiveve (metoda e gjerë)	31.27	Liquid assets as a percent of total assets (broad measure)
Aktive likuide ndaj totalit të aktiveve (metoda bazë)	30.72	Liquid assets as a percent of total assets (core measure)
Aktive likuide ndaj detyrimeve afatshkurtra (deri në një vit) (metoda e gjerë)	44.80	Liquid assets as a percent of short-term liabilities (broad measure)
Aktive likuide ndaj detyrimeve afatshkurtra (deri në një vit) (metoda bazë)	44.02	Liquid assets as a percent of short-term liabilities (core measure)
Kthimi nga aktivet (ROA) (bazë vjetore) (fitimi neto para taksave)	1.67	Return on assets (ROA) (annual basis) (net profit before taxes)
Huatë me probleme (bruto) ndaj totalit të huave (në %)	3.85	Nonperforming loans (gross) as a percent of total loans (in %)
Tregues të të ardhurave dhe shpenzimeve		Income and expense-based
Marzhi i interesave ndaj të ardhurave bruto	76.51	Interest margin to gross income
Shpenzime jointeresi ndaj të ardhurave bruto	55.66	Noninterest expenses to gross income
Të tjera		Other
Numri i bankave	11.00	Number of banks

Burimi: Banka e Shqipërisë

Source: Bank of Albania